



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 23 QERSHOR 2011

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE
23. JUNA 2011. GODINE

QERSHOR – JUNI
2011

E enjte, 23.06. 2011, ora 10:00

Drejton seancën: Kryetari i Kuvendit të Kosovës, zoti Jakup Krasniqi

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

I nderuar ministër,

I hapi punimet e seancës plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës:

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Në emër të Grupit Parlamentar është lajmëruar deputetja Donika Kadaj - Bujupi.

DONIKA KADAJ – BUJUPI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

Kolegë deputetë,

Nuk do të merrja mundin të komentojë këtë artikull banal për të cilin do të flas sot, sepse në te nuk ka asgjë nga etika pika gazetareske, do të thotë s'ka mbeturë as shkronja "e" nga fjala etikë. Mirëpo, duke marrë parasysh se e lexova, do të thotë, ditë më parë, më 21 qershor të vitit 2011, më duhet ta komentoj pa tjetër, sepse autori është hiq më pak zëvendësministri i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Qeverinë gjigante Thaçi 2.

Derisa mjedisi në Kosovë vazhdon të jetë i kontaminuar, vazhdon mungesa e gjelbërimit, i cili bëhet vetëm para fushatave, na kujtohen të gjithëve ata 2 milionë fidanë që gjenin hapësirë propagantistike, sikur të bëhej fjalë për ullinjtë e Skënderbeut dhe jo për disa fidanë të paguara shtrenjtë nga buxheti i Kosovës, të mbjella jashtë sezoni, të cilat mbijetuan vetëm 2 a 3 ditë. Do të thotë, janë disa nga problemet me të cilat ballafaqohet mjedisi në Kosovë. Edhe më tutje ne vazhdojmë të shkatërrojmë pyjet, të na ndoten dhe eksploatohen lumenjtë, vazhdon problemi i Hades, i Dardhishtës, industritë si KEK-u vazhdojnë të helmojnë qytetarët e Obiliqit. Ndërsa, Qeveria nuk merr mundin të investojë sado pak me projektet mjedisore. Nuk ka strategji as plan për mjedisin dhe pasojat po i vuajmë ne, por edhe më tepër do t'i vuajnë gjeneratat që vinë pas nesh.

Dhe, siç tha një ditë një zyrtar i Qeverisë, kemi shumë punë për të bërë, prandaj jemi shumë ministra, zëvendësministra, zëvendëskryeministra. Edhe në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit hapësinor ka shumë zëvendësministra, këshilltar dhe staf tjetër, të cilët paguhen goxha shtrenjtë për të punuar, për të hartuar politika të cilat do të aplikohen në të mirë të këtij vendi dhe qytetarëve të saj. Mirëpo, në vend të këtij angazhimi në atë kohë, ata domethënë kohën e humbin duke kontaminuar opinionin me fyerje, me cilësime, me theks të veçantë duke shpalosur mendimet dhe qëndrimet e tyre shoviniste për gratë në politikë. Dhe, ky zëvendësministër, një nga aktivistët e partisë opONENTE, me shkrimin të cilin e përmenda, më 21 qershor e quan një "biondinë politike" dhe madje, madje ai akuzon mediat që i dhanë hapësirë, siç e quajti ai, "një biondine politike", e cila me keqardhje i nderuari kryetar, kërkoj falje se është gjuhë jo parlamentare, por është shkruar nga një zëvendësministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, kishte thënë "kishte transformuar gojën e saj në auspuh". Edhe njëherë kërkoj falje që më duhet të citoj një shkrim të tillë.

Mirëpo, bëhet fjalë për përfaqësues të Qeverisë Thaçi dhe unë besoj që ky cilësim i grave të Kosovës duhet të gjykohet këtu nga gjithë ne, pa dallim të partive politike, po do të gjykohet sigurisht edhe nga gratë e Kosovës. Prandaj, sot e kam marrë fjalën që të flas si deputete e këtij Kuvendi, por edhe në emër të grupit të grave parlamentare dhe të pyes: “A është kjo politikë e Qeverisë Thaçi, që puna dhe roli i gruas në politikë të cilësohen si “biondinë politike”? A është politikë e Qeverisë Thaçi eliminimi dhe dekurajimi i grave në politikë, fyerja nga ana e Kabinetit Thaçi, i cili paguhen nga paratë tona, sepse ne përbëjmë 52% e popullsisë së Republikës së Kosovës. A është aprovuar ky koncept mesjetar shovinist nga ndonjëra nga të ashtuquajtura strategji të promovuara kohëve të fundit nga Qeveria Thaçi, dhe pasi çdo ditë Qeveri Thaçi e ka gojën plotë Evropë, a mendon që Evropa ka vend për njerëz si ju. Ky shkrim është botuar më 21 qershor 2011, në gazetën “Express” dhe unë ju kujtoj edhe një herë që gratë përbëjnë gjysmën e popullsisë së Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Në emër të grupit, a ka dikush tjetër? Në emër të grupit të Partisë Demokratike, Berat Buzhala.

BERAT BUZHALA: I nderuar kryetar,
Ministër, zëvendëskryeministër,
Të nderuar kolegë deputetë,

Kjo çka dola unë të flas në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, ka të bëjë me protestën apo sfilatën e hipokrizisë që dje e ka pas Lëvizja “Vetëvendosje”. Nuk dyshoj dhe nuk mendoj që dikush prej neve këtu mbron korrupsionin apo hajninë. Mirëpo, gjëja më e shpifur është kur ata që protestojnë janë hipokritë edhe i caktojnë disa standarde për të cilat unë sot kisha dashtë të flas dhe ta gjykoj Lëvizjen “Vetëvendosje” mbi standardet që vetë i kanë caktuar. Disa prej eksponentëve që dje kanë qenë në protestën e Lëvizjes “Vetëvendosje”, sigurisht që bien në atë kurthin që ata e konsiderojnë që është hajni. Kisha dashur t’i përmend disa emra, për shembull në krye të protestës ka qenë së bashku me liderin Albin Kurti, Fisnik Ismajli, i cili e ka fituar një tender 4 milionë euro prej Postës dhe Telekomit të Kosovës, me një kompani greke, po them greke, ndoshta nuk po gaboj. Atëherë, nëse ata kanë të drejtë të fitojnë tenderë, ndoshta në mënyrë legale, pse të tjerët këtu s’kanë të drejtë të bëjnë biznes dhe të merren me veprimtari biznesi, ose si mundet një njeri që i prinë protestës dhe kërkon ndëshkimin e hajnisë, vetë të jetë i involvuar në tenderë kaq të mëdhenj, 4 milionë. Një eksponent tjetër, i cili është jashtëzakonisht i rëndësishëm, nuk po dua ta gjykoj askënd, mirëpo vetë keni dëshirë të përmendni baballarë, keni dëshirë të përmendni vëllezër.

Kisha pasur dëshirë ta përmend Shpend Ahmetin edhe vëllain e tij, i cili është largua prej doganës, të më japë përgjigje pse është larguar prej doganës. Apo eksponentin tjetër, Alma Lama, nuk qenka këtu. E akuzoni Behxhet Pacollin aq rëndë, a mundet të më tregojë Alma për veprimtarinë e saj në Partinë e Behxhet Pacollit, ka qenë eksponente në këtë subjekt politik gjatë zgjedhjeve lokale të vitit 2007, edhe Florin Krasniqin dhe kapitalistët tjerë të kësaj partie. Unë nuk po them që këta po bëjnë keq që po bëjnë biznes, mirëpo të mos bëhen hipokrit dhe të kërkojnë parti egalitare përballë qytetarëve, kur në anën tjetër kemi milionerë, kemi njerëz kapitalistë brenda këtij subjekti. Ju mund

të vazhdoni për t'u marrë me veprimtari të biznesit, mirëpo qytetarët mos të mendojnë që ju keni dal prej një laboratorit të sinqeritetit apo të pastërtisë. Edhe ju jeni mëkatarë, sikur ne të gjithë të tjerët. Ne veprojmë brenda një ambienti të përbashkët, edhe biznesit, edhe të gjitha të tjerave.

Më re ndër mend edhe ti, Visar. Do të kishte qenë mirë t'ju tregosh qytetarëve edhe ti për Trustin Pensional. Ti je njeri adekuat, tregoju ku janë paratë e Trustit Pensional. Ju gjithë ditën flisni për Trustin Pensional, ti ke punuar aty, tregojuni qytetarëve ku janë ato para, edhe ne kemi dëshirë ta dimë. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Në emër të Grupit Koalicioni për Kosovë të Re, Amir Ahmeti e ka fjalën.

AMIR AHMETI: I nderuar kryetar,
Kabinet qeveritar,
Kolegë deputetë,
Të nderuar qytetarë të Kosovës,

Si përfaqësues të qytetarëve të Kosovës po njëherësh edhe si deputet nga Prishtina, desha të shfrytëzoj hapësirën kohore për deklarinimin jashtë rendit të ditës për të shprehur para juve, në emër të Grupit tonë Parlamentar, një brengë dhe një shqetësim të qytetarëve të Prishtinës.

Mendoj se nuk kemi nevojë dhe nuk duhet të presim që përmes shprehjes së pakënaqësisë në mënyrë demonstrative të qytetarëve, ne si organe reprezentative të popullit të vetëdijësohemi për plotësimin e disa nevojave themelore të tyre. Për arsye se duhet të jemi organe që reprezantojmë dëshirën dhe vullnetin e popullit dhe zgjidhjet që ofrojmë për çështje nga më të ndryshme, të jenë në harmoni me dëshirën dhe vullnetin e atyre që na kanë zgjedhur.

Fenomeni i faljes së xhumasë në rrugët e Prishtinës, javën e kaluar, do të duhej të ishte argument i mjaftueshëm që të kuptojmë se disa organe të pushtetit tonë nuk janë duke i përmbushur kërkesat dhe nevojat e qytetarëve tanë.

Ndërtimi i një xhamie të madhe në Prishtinë është nevojë imediate dhe përmbushje e vullnetit të qytetarëve tanë. Duhet sa më parë të realizohet në Prishtinë projekti i ndërtimit të xhamisë, e cila do t'i përmbushë kërkesat e besimtarëve islamë, e një ndër ta këta besimtarë që praktikojnë faljen 5 herë në ditë, jam edhe unë, por edhe deputetë të tjerë të këtij parlamenti.

Krahas kësaj, është më se e nevojshme që të realizohet edhe projekti i ndërtimit të Qendrës Islame të Kosovës, po ashtu në Prishtinë, si kryeqendër e Kosovës, që është Prishtina. E më lejoni të shtoj se këto projekte nuk janë të pozitës, e as të opozitës, por janë me karakter gjithëpërfshirës për realizimin e të cilave duhet të kemi sens edhe pozita, edhe opozita.

Çështja e besimit dhe krijimi i kushteve themelore të ushtrimit dhe të praktikimit të riteve fetare duhet të jetë preokupim i të gjithë neve, pa marrë parasysh përkatësinë tonë politike, etnike apo fetare.

Mbes me shpresë që të kemi qasje serioze të organeve tona në Prishtinë dhe në mbarë Kosovën në përmbushjen e kërkesave të qytetarëve tanë. Ju faleminderit, shumë!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: I nderuari kryetar i Parlamentit, Kabinet qeveritar, Të respektuar deputetë, Parlamenti i Kosovës, si përfaqësues i popullit, përbëhet nga burra dhe gra të regjioneve të ndryshme, të profesioneve dhe të moshave të ndryshme.

Deputetët, përveç që ngrisin çështje, tentojnë të pengojnë dukuritë negative përmes ligjeve, por edhe të vendosin trende të reja në shoqëri. Të nderojnë mentalitetin me qëllim të promovimit të politikave përparimtare për demokratizimin e shoqërisë dhe sjelljes politike. Dhe, e gjithë kjo nuk është e mundur pa pjesëmarrjen aktive e të fuqishme të gruas. Pa qenë gruaja partnere e barabartë në të gjitha fushat e shoqërisë, në jetën institucionale dhe në vendimmarrje. Po, a është sot gruaja partnere e barabartë me burrin. Sot 95% e patundshmërive është në pronësi të burrave, 98% e bizneseve janë pronarë burrat. Gratë janë ato të cilat mund të vriten në mes të ditës nga burrat, pa marrë parasysh a mbajnë jetën e re brenda trupit të vetë apo jo. Gruaja nuk ka asnjë monument nga lufta, ndonëse shumë prej tyre kanë luftuar dhe kanë qenë viktimë.

Kuvendi, si përfaqësues i popullit, sot vetëm falë kuotës, ka 70% burra dhe 30% gra. Ndonëse jashtë Kuvendi jetojnë 50 me 50, bile pak më tepër për gruan.

Kryesia e Kuvendit është Kryesi e baballarëve të Kuvendit. Nga 13 komisione parlamentare dhe dy komisione ad-hoc për reformën zgjedhore, vetëm dy udhëhiqen nga gratë.

Te kryetarët e grupeve parlamentare, shqyr zotit, kemi vetëm një grua, edhe atë tash së fundit.

Këto dhe shumë të tjera kërkojnë një vëmendje të veçantë, një sensibilizim dhe masa konkrete, në mënyrë që të ndërroj jo vetëm imazhi i Kosovës, por të iniciohet një ndryshim real në jetën tonë, në demokratizimin e shoqërisë tonë. Një shtet nuk mund të përparojë, meqë gjysma e popullit të vet nuk është krah për krah me gjysmën tjetër në vendimmarrje, për ta bërë shtetin vend më të mirë për vete dhe për gjeneratat që vinë.

E fillimi i këtij ndryshimi të vështirë dhe afatgjatë mund të nisë nga ky Kuvend, nga Kuvendi i përfaqësuesve të popullit, sepse këtë u kemi borxh atyre 50% të popullsisë që janë jashtë këtij Kuvendit.

Ndërsa, dëshiroj ta shfrytëzoj rastin edhe t'iu bashkëngjitëm kritikave nga ana e Donikës. Në anën tjetër, nga Qeveria, kemi një shkrim në Express me nënshkrim të zëvendësministrit me fjalë fyese të nivelit më të ulët ndaj një gruaje në politikë, gjë e cila mund të cilësohet vetëm si skandaloze. Ky preson dhe Qeveria duhet të kërkojnë së paku falje për këto fjalë dhe të deklarohet - a janë këto qëndrime zyrtare të Qeverisë ndaj gjinisë femërore dhe si e paramendojnë rrugën për Evropë me këto qëndrime dhe fjali...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Faleminderit, edhe pse problemi i përfaqësimit të grave në organet e Kuvendit është kryesisht dhe kryekëput i grupeve parlamentare dhe jo i Kryesisë së Kuvendit!

Fjalën e ka deputetja Alma Lama.

ALMA LAMA: Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Më vjen keq që më duhet t'i kthej një përgjigje një ish kolegu, që foli marrëzira këtu. Mund të them që zoti Buzhala ngatërron punën me praktikën korruptive. Ndoshta kjo është e vetmja mënyrë e punës që t'i njeh, Berat, të tjerët nuk i njohin. Kaq sa iu përket juve. Të lutem, mos kalo më në fjalë të tilla, se nuk beson as njëri, kjo është çështja. Besueshmëria krijohet me vite dhe me punë, kjo!

Arsyeja se pse dola këtu, ka të bëjë në lidhje me një letër që Avokati i Popullit i ka dërguar Kuvendit të Kosovës dhe, besoj, të gjithë deputetëve. Kam ngre shqetësimin e madh se institucioni i tij është tërësisht përpara falimentimit, mund të themi. Citoj në letër, ku thuhet që ka vështirësi. Këto vështirësi janë tërësisht pasojë e mospërkrahjes institucionale nga organet më të larta të vendit dhe mosrespektimit të pavarësisë së institucionit. Në rast se keni parë letrën, një nga pikat më të rëndësishme thuhet që është cenuar pavarësia kushtetuese e këtij institucioni. Duke qenë se ky institucion është shumë i rëndësishëm dhe është adresa e vetme për shumë qytetarë të cilët shpesh ndeshen me praktika jo të mira nga ana e institucioneve të Kosovës, mendoj që roli i tij është dashur të forcohet nëpër vite dhe jo të zbehet apo të dobësohet, siç është tani.

Cungimi i imunitetit të personave që punojnë në këtë institucion, ulja e buxhetit, i cili më duhet të them se është qesharak, Qeveria ka mundur të bëjë disa shkurtime, për shembull në blerje kolltukësh, të cilat i ndërron çdo vit dhe t'ia japi këtë buxhet, t'ia dedikojë institucionit të Avokatit të Popullit.

Nga ana tjetër, më duket se kemi paka shumë një histori të ngjashme edhe me Kuvendin, sepse po të bëjmë një krahasim, vetëm Zyra e kryeministrit e ka buxhetin afërsisht 10 milionë, domethënë më shumë se sa Kuvendi.

Prandaj, është rasti që, me qenë se ky është një institucion i cili është themeluar nga Kuvendi dhe varet nga ne, që të ndërmarrin masa për t'i kthyer këtij institucionin dinjitetin dhe pavarësinë kushtetuese.

Është shumë mirë që Avokati i Popullit na është drejtuar me këtë brengë dhe mendoj që duhet të reagojmë.

Çështja e dytë, për të cilën dua të flas, në rast se kam kohë, është në lidhje me intelektualin e madh shqiptar Ukshin Hoti. Para disa ditësh vizitova shtëpinë e tij muze. Të them të drejtën, kam pritur të shoh një shtëpi tamam muze, ku janë vendosur veprat e tij, fotografitë e tij dhe ku njerëzit të cilët duan të shkojnë dhe ta vizitojnë, të kenë çka të shohin nga

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Është dashur ta kërkojë fjalën në emër të grupit.

ALMA LAMA: E thashë pra, dhe u ndjeva me të vërtetë shumë keq kur pashë një shtëpi tërësisht të rrënuar, të mbuluar nga barishtet, krejtësisht jo dinjitoze për një intelektual kaq të madh. Kam parasysh që Kosova është e mbushur me përmendore heronjsh, ka fabrikim heronjsh, inflacion heronjsh, ka edhe heronj me meritë, natyrisht. Është dashur një përkujdesje shumë më e madhe institucionale për këtë intelektual të madh mbarë kombëtarë. Mund të them që fati i tij është vërtetë tragjik, po bëhet edhe më tragjik duke pasur parasysh çfarë pasardhësish politikë ka lënë pas. Më duhet t'ju them se askush nuk mund të bëhet lider i madh në rast se është njeri i vogël. Kjo është për të gjithë liderët e Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Blerta Deliu – Kodra.

BLERTA DELIU – KODRA: Faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Në seancat e kaluara të Kuvendit, jo rrallë një pjesë e madhe e deputetëve të opozitës kanë kërkuar ndërprerjen e seancave të Kuvendit pas ndërprerjes së transmetimit nga ana e Radiotelevizionit të Kosovës.

Pa dashur të hyjë në atë se a po përdoret Kuvendi si vend për marketing politik, ku deputetët duke ditur se janë në transmetim të drejtpërdrejtë, jo rrallë po e përdorin foltoren dhe hapësirën që e kanë për të ofenduar. Konsideroj se mediumi publik duhet të mendojë që sa më shpejtë që është e mundur ta hapë një kanal të ri televiziv, i cili do të jetë i dedikuar vetëm për punën e Kuvendit të Kosovës. Kur e them këtë, konsideroj se në këtë kanal do të transmetohen seancat e Kuvendit dhe puna e deputetëve nëpër komisione parlamentare. Një praktikë të tillë e kanë edhe një pjesë e konsiderueshme e kanaleve televizive të Evropës, përfshirë këtu kanalin britanik BBC Parlament, kanalin kroat HRT dhe HRT Parlament, kanalin Turk TRT dhe shumë kanale të tjera. Me këtë praktikë, edhe RTK-së do t'i lirohej hapësira në kanalin ekzistues, ndërkohë që deputetët nuk do të mund të gjenin më arsye që të ndërpresin seancat e Kuvendit.

Ligji ekzistues i RTK-së lejon hapjen edhe të kanaleve të tjera, prandaj kjo nuk do të paraqiste ndonjë problem për Radio Televizionin e Kosovës. Me hapjen e këtij kanali televiziv për Kuvendin, do të zhvillohej edhe më shumë praktika parlamentare në Kosovë

dhe çdo gjë do të ishte transparente karshi qytetarëve të Republikës së Kosovës, duke i kontribuar kështu edhe zhvillimit të demokracisë në vend. Faleminderit!

KRYETARI: Fjalën e ka deputetja Afërdita Berisha – Shaqiri.

AFËRDITA BERISHA – SHAQIRI: I nderuar kryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar qytetarë,

Në verën e vitit 1999 ekonomia e Kosovës ishte copë - copë pas dekadash krize ekonomike dhe politike, keqmenaxhimit, mungesës së investimit, shkatërrimit dhe luftës. Ndërmarrjet e Kosovës operonin në një gamë të gjerë sektorësh, duke përfshirë këtu minierat, bujqësinë, prodhimin e ushqimeve, përpunimin e metalit, materialet e ndërtimit dhe industri të tjera.

Procesi i privatizimit nuk i është nënshtruar shumë analizave. Pyetja se pse nisi privatizimi i menaxhuar nga ndërkombëtarët, mbetet pa përgjigje. Mënyra se si u krye, mbetet pa u shpjeguar dhe niveli i përgjithshëm i suksesit të tij gjithashtu i ka shpëtuar analizës.

Ndërkohë, në Kosovë nuk është përmirësuar situata ekonomike dhe sociale për 44% të popullsisë që jetojnë në varfëri. Historikisht, pronësia shoqërore lindi pas distancimit të Jugosllavisë nga Bashkimi Sovjetik dhe modeli ekonomik Sovjetik në vitet '50, kur pronësia shoqërore zëvendësoi pronësinë shtetërore, që ishte ligjërisht më e drejtpërdrejtë. Ndërsa pronësia publike jugosllave është e barabartë me pronësinë shtetërore, këto dy terma vinë nga i njëjti burim. Në Kosovë u privatizua pasuria e këtij populli të shumë vuajtur, të cilit situata ekonomike dhe sociale pas këtij procesi vetëm sa iu rëndua dhe aspak nuk u përmirësua. Qeveria është dashur ta ndërpresë, ta analizojë, të gjejë formatin e përshtatshëm e jo të vazhdojë të privatizojë ngutshëm edhe pasurinë publike, siç është Posta, e cila i sjell këtij buxheti miliona. Është afër mendsh të frikohemi se edhe kjo do t'i falet, siç u falën ndërmarrjet e tjera. Një ndërmarrje privatizohet vetëm nëse ajo nuk është tërheqëse për sektorin. Duket sikur ky proces s'ka pasur asnjë diskutim për qasje ekonomike alternative.

Edhe pse nuk është bërë asnjë vlerësim gjithëpërfshirës, deri më tani, i ndikimit ekonomik të privatizimit në Kosovë, dëshmitë në dispozicion tregojnë se procesi ka ndikuar më shumë në kufizimin e potencialit socio-ekonomik të Kosovës, duke ngushtuar mundësitë e funksionimit të ndërmarrjeve dhe duke i transformuar ato në para të vlerës së ulët në një periudhë dhe duke i bllokuar punonjësit që të mos punonin, në pritje të privatizimit, dhe duke mos ndihmuar për punësi ose mbrojtje sociale, pas privatizimit.

Duket sikur privatizimi në Kosovë ka çuar në humbje të vendeve të punës. Sindikata e Kosovës ka përllogaritur se 70 mijë punëtorë kanë mbetur pa punë, pa pensione dhe pa asistencë sociale për shkak të privatizimit.

Në nivelin e ekspertëve të pavarur ai përshkruhet si një katastrofë, po thuaj një dështim i plotë dhe si një dështim ekonomik. Argumenti se privatizimi ishte i nevojshëm për shmangur degradimin e ndërmarrjeve publike apo shoqërore dhe për të mbrojtur të mirën e përgjithshme të Kosovës, duket jo bindës para stagnimit dhe rënies pas procesit të privatizimit. Nga kjo që po them, nuk do të thotë se jemi kundër privatizimit, si proces, por jemi kundër mënyrës, formatit, metodës dhe strategjisë që u përdor për privatizimin e ndërmarrjeve kosovare. Ju faleminderit!

KRYETARI: Deputeti Glauk Konjufca e ka fjalën. 4 minuta i ka Glauk Konjufca.

GLAUK KONJUFCA: Deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Nga qeveritarët në pushtet, motoja e demonstratës së djeshme, e cila u organizua nga ne, u quajt fyerje. Së pari, po më vjen mirë që qeveritarët tanë dhe shokët e tyre deputetë në këtë Kuvend, si lloji i Berat Buzhalës, e kanë mizën masë veshi, siç thotë populli, dhe po e gjejnë veten të cenuar nga motoja e demonstratës sonë, e cila u quajt “kundër hajnisë”. Sikur të kishin qenë plotësisht të pastër këta politikanë, nuk do të ishin ndjerë në siklet. E sa i përket fyerjes, si të tillë, ne mendojmë që e vërteta duhet të thuhet, sa do që për dikë kjo mund të merret si fyerje. Por, fyerja më e madhe që po iu bëhet qytetarëve të Kosovës, është korrupsioni që ka përfshirë të gjitha segmentet e qeverisjes në Kosovë.

Në Kosovë keqpërdoret paraja publike prej tenderëve për lapsa e kalendarë, e deri te tenderët dhjetëra milionësh të rrugëve. Pikërisht pse keqpërdorimet kanë qenë të larta dhe pasuria e qytetarëve po dëmtohet qëllimisht, sot kryetar bordesh si dhe shefat e ndërmarrjeve tona publike po përfundojnë hetime, hetime këto që po çojnë drejt e te kryeministri.

Gjatë kësaj jave, në hetime për dyshime korrupsioni dhe tenderë përfundoi edhe një tjetër ministri dhe kjo është e mjaftueshme për të konkluduar se kemi të bëjmë me keqpërdorim kronik të fondeve publike nga kjo Qeveri dhe kjo është fyerje për qytetarët e Kosovës, Berat, e jo nëse thuhet e vërteta.

Berat Buzhala na flet për tenderë, merreni me mend, njeriu që është pronar i firmës që gurëve vullkanikë “Arena Invest” e regjistruar në Leposaviq, ashtu që të marrë tenderë nga shefi i tij, Hashim Thaçi, që e ka parashutuar Beratin në partinë e tij. Në momentin që Berat Buzhala ka përfunduar në partinë në pushtet, e kam ditur automatikisht që partia më e madhe në pushtet do të përfundojë në koalicion me AKR-në, sepse deputeti që na foli dhe na e moralizoi demonstratën tonë këtu, në fakt është ndërmjetës financiar ndërmjet Pacollit edhe Thaçit.

Dhe, ky deputet që na flet për gazetarinë dhe fjalën e lirë në Kosovë, është zbuluar se ka shkruar shkrime me porosi dhe me pagesë për Behxhet Pacollin. Njerëzve të tillë nuk i thuhet deputetë, po njerëzve të tillë ju thuhet mercenarë. Për çfarë morali po na flet deputeti në fjalë, kur shumicën e pasurisë që e ka, e ka duke bërë këtë punë të pandershme. Faleminderit!

KRYETARI: Replikë nuk ka, jo!

Deputeti Bekim Haxhiu, e ka fjalën.

BEKIM HAXHIU: I nderuar kryesues,

Të nderuar deputetë,

Kabinet qeveritar,

Javën që lamë pas, do të rrokë një temë tjetër që lamë pas, ka përfunduar një edicion i garave sportive, me gjithë vështirësinë financiare organizative të klubeve dhe federatat përmbyllën një edicion garash, kur të rinjtë tanë shfaqën virtytet e detyre të larta sportive, me gjithë kushtet e vështira në të cilat punojnë.

Si zakonisht, as në këtë edicion garash nuk kishte ndonjë shpërblim për ta, as nga federatat, ngase ato po thuaj se të gjitha janë pa buxhet as nga Ministria e Sportit, e as nga ndonjë institucion tjetër. Për rezultatet kulminante kampion të shpallur u shkrua nja tri ditë nëpër faqe sportive dhe këtu përfundon odisejada e sportistëve kosovarë, të cilëve u mohohet e drejta për të bërë gara në arenën ndërkombëtare. Sportistët tanë kanë vështirësi të bëjnë edhe ndeshje miqësore me bashkëmoshatarët e tyre në botë, ngase përveç që një pjesë e federatave botërore nuk lejojnë një gjë të tillë, ata edhe kur kanë ftesa, shpeshherë edhe refuzohen të pajisen me viza nga ambasadat e huaja këtu. Rasti i fundit i Klubit futbollistik “Trepça”, e cila është ftuar në turnirin e futbollit në Austri dhe kur ka paraparë të zhvillojë ndeshje me Shahtarin e Ukrainës, me Dinamon e Bukureshtit, Apoelin e Tel Avivit dhe me Zbrukun e Austrisë, has në vështirësi në pajisje me viza. Kampioni i Kosovës është paraparë të luaj me Kampionin e Ukrainës, shtet i cili ende s’e ka njohur Kosovën, por në sport po. Prandaj, janë të patolerueshme vështirësitë të cilat i bën Ambasada e Austrisë dhe ajo e Zvicrës për të pajisur Klubin futbollistik “Trepça” me viza. Përkundër asaj që Federata i ka dhënë mbështetje, Ministria e Sportit, gjithashtu, dhe Ministria e Punëve të Jashtme ka dhënë notën verbale për futbollistët tanë për të udhëtuar në ndeshje miqësore.

Kërkojmë nga instancat më të larta shtetërore që të kërkohet sqarim nga Ambasada e Zvicrës dhe ajo e Austrisë për zvarritjen dhe pengesën që u bë KF “Trepça” për pajisje me viza për turnirin në Austri. Shfrytëzoj rastin, kolegë deputetë të nderuar, t’ju apeloj që të angazhohemi edhe më shumë që të kalojnë ligjet të cilat do të avancojnë zhvillimin e sportit, si Ligjin për sponzorizim dhe Ligjin e sportit.

Gjithashtu, edhe infrastruktura sportive është në gjendje të mjerueshme edhe në shumë qytete dhe pa pronarë të definuar qartë. Parlamenti i Kosovës është dashur t’ju japë klubeve mundësi që ato të avancohen dhe të zhvillohen, duke ditur edhe titullarin e pronësisë, duke bërë klubet titullarë, qoftë në format e pronësisë së partneritetit publiko - privat apo koncesioneve, ashtu siç kanë zhvilluar shtetet në rajon. Mos të harrojmë se kemi entuziastë të sportit, të cilët e mbajnë sportin tani 20 vjet dhe vazhdon sporti të zhvillohet falë këtyre personave.

Me këtë do të kishte mundësi që vërtet sportistët tanë të zhvillohen, Kosova ka kapacitete të krijojë sportistë kulminantë, ngase ka rini dhe duhet ta shfrytëzojë këtë potencial. Andaj, të angazhohemi për këtë rini, përpara se rininë tonë ta adresojmë rrugëve, me ide

të kota të paradokseve, ku milionerët i demonstrojnë xhepat bosh. Andaj, të angazhohemi...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, 30 sekonda!

BEKIM HAXHIU: 10 sekonda, faleminderit kryetar!

Jo rastësisht thuhet që “Mendja e shëndoshë, rrinë në trupin e shëndoshë”.

KRYETARI: Faleminderit!

Kemi harxhuar kohën që kishim prej 30 minutash.

Po, më lejoni, unë nuk kam ndërhyrë në fjalët që i keni thënë, por po kërkoj edhe një herë nga deputetët që ta lexojnë Rregullën 47, për deklaratimet jashtë rendit të ditës, pse bëhen, në mënyrë që vërtet disa tema mos t’i harxhojnë kot në këto deklarata jashtë rendit të ditës. Aty është thënë qartë: “Çështjet që janë në interes të publikut dhe që s’mund të ngriten në rend të ditës” dhe unë mund t’ju them që shumica e atyre që po thuhën, nuk janë në interes të publikut dhe nuk janë çështje që s’mund të ngriten në rend të ditës.

Para se të vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës – Koha për pyetjet parlamentare, që janë dy pyetje, e ministrat që iu janë drejtuar pyetjet, s’janë asnjëri këtu, kemi një kërkesë nga kryetarja e Komisionit për Buxhet dhe Financa, deputetja Safete Hadergjona.

SAFETE HADERGJONAJ: Kryetar,

Të nderuar anëtarë të Kabinetit qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka bërë një kërkesë kryetarit të Kuvendit që të plotësohet rendi i ditës i mbledhjes së sotme me një pikë të rendit të ditës – Shqyrtimi i dytë i Projektligjit numër 04/L-04 për sigurimin e detyrueshëm nga auto-përgjegjësia ndaj palëve të treta.

Arsyeja pse kemi kërkuar që të plotësohet ky rend i ditës, ka qenë se Komisioni për Buxhet dhe Financa ka marrë një kërkesë nga Banka Qendrore e Kosovës për përsheptimin e procedimit për aprovim të Projektligjit për sigurimin e detyrueshëm nga autopërgjegjësia, me arsyetimin se e ka pranuar nga Këshilli i byrosë së sistemit të kartës së gjelbër të sigurimit përkitazi me njoftimin e Këshillit Drejtues të Këshillit të Byrosë, me të cilën mbështetet propozimi i Komiteti për aplikim i Këshillit të Byrosë që Republikës së Kosovës t’i mundësohet aplikimi për anëtarësim.

Sipas Bankës Qendrore, ky njoftim është bërë me datën 3 qershor 2011, në ditën kur Kuvendi i Kosovës e kishte në shqyrtim Projektligjin për sigurimin e detyrueshëm të auto-përgjegjësisë, që ka kaluar në lexim të parë, aprovimi i të cilit, sipas Bankës Qendrore, është parakusht për themelimin e Byrosë Nacionale të Sigurimeve të Kosovës si dhe kusht themelor për aprovimin e kërkesës së Kosovës për anëtarësim. Kjo na ka imponuar që ne të procedojmë urgjent këtë projektligj për të mundësuar themelimin e

Byrosë Nacionale të Sigurimeve të Kosovës dhe aplikimin për anëtarësim para datës 5 korrik 2011, në mënyrë që aplikacioni për anëtarësim i Kosovës të radhitet në agjendën e Këshillit të Byrosë për vitin 2011.

Komisioni për Buxhet i ka përgatitur amendamentet, komisionet tjera, Komisioni për Integritet Evropian, Komisioni për Legjislacion dhe Komisioni për të Drejtat e Komuniteteve dhe Interesat e Komuniteteve i kanë shqyrtuar amendamentet e Komisionit për Buxhet dhe Financa. Prandaj, kërkoj që në emër të Komisionit, sot të futet si pikë e rendit të ditës – Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto-përgjegjësia ndaj palëve të treta. Faleminderit!

KRYETARI : Faleminderit!

A jeni dakord që ky ligj të radhitet si pikë e fundit të rendit të ditës? Kush është “për”? Faleminderit! A ka “kundër”? Një. Mirë, kjo i shërben demokracisë. Faleminderit!

Pra, në sallë janë 78 deputetë dhe Kuvendi e radhitë në pikën e fundit të rendit të ditës – Shqyrtimi i dytë i projektligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto-përgjegjësia ndaj palëve të treta. Ju falënderoj për votimin! Vazhdojmë me pikën e radhës.

2. Koha për pyetje parlamentare

I kemi dy pyetje parlamentare. Deputetja Afërditë Berisha-Shaqiri, pyetje për zëvendëskryeminstren dhe ministren Kusari - Lila. Deputete, a do të parashtrosh pyetjen? Regjia, fjalën deputetes Afërditë Berisha – Shaqiri.

AFERDITA BERISHA – SHAQIRI: Faleminderit, kryetar!

Herën e kaluar kërkoja që dikush prej Kabinetit qeveritar të më përgjigjet. Sot nuk mundem as të kërkoj, sepse dy ministra i kemi prezentë, kështu që nuk kam nevojë për ta lexuar, me qenë se nuk e kemi zëvendëskryeminstren këtu. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, deputete!

Deputeti Goran Marinković, pyetje për ministrin Besim Beqaj. As deputeti s’është, as ministri.

Vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 16 qershor 2011,

Pyes, nëse keni vërejtje në Procesverbal? Nëse jo, konstatoj se Kuvendi miratoi Procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 16 qershor 2011.

Vazhdojmë me pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për nismën legislative

Mungon përfaqësuesi i Qeverisë.

Vazhdojmë me pikën e radhës.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tregtinë e brendshme

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tregtinë e brendshme dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetarin e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, deputetin Zenun Pajaziti, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime. Deputeti, s'është këtu. A do dikush ta marrë fjalën, apo po hymë në procedurën e votimit.

Nëse jo, atëherë hyjmë në procedurën e votimit.

Votojmë amendamentin 1

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Prezentë janë 78 deputetë.

Konstatohet se me 72 vota “për”, asnjë “kundër” dhe një ka abstenuar, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2

Votojmë tash:

Konstatohet se me 73 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3

Votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota “për”, asnjë “kundër” dhe një abstenim, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4

Votojmë tash:

Konstatohet se me 70 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 67 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 71 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7, i fundit.

Votojmë tash:

Konstatoj se me 71 vota “për”, asnjë “kundër” dhe një abstenim, miratohet amendamenti 7.

Tash votojmë ligjin në tërësi.

Votojmë tash:

Në sallë kemi 80 deputetë.

Konstatoj se me 72 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 3 abstenime, Kuvendi miratohet Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tregtinë e brendshme. Faleminderit!

Kalojmë në pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare

Komisionet parlamentare kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Në emër të Komisionit, a e do kush fjalën, a të shkojmë në procedurë të votimit. Shkojmë në procedurë të votimit.

Votojmë amendamentin 1

Votojmë tash:

Konstatoj se me 73 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2

Votojmë tash:

Konstatoj se me 72 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 2 abstenime, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3

Votojmë tash:

Konstatoj se me 71 vota “për”, asnjë “kundër” dhe 1 abstenim, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4

Votojmë tash:

Konstatoj se me 74 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5

Votojmë tash:

Konstatoj se me 73 vota “për”, një “kundër” dhe një abstenim, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6

Votojmë tash:

Konstatohet se me 74 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7

Votojmë tash:

Konstatohet se me 73 vota “për”, asnjë “kundër” dhe një abstenim, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8

Votojmë tash:

Konstatohet se me 72 vota “për”, asnjë “kundër” dhe një abstenim, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9

Votojmë tash:

Konstatohet se me 62 vota “për”, asnjë “kundër” dhe një abstenim, miratohet amendamenti 9.

Tash votojmë amendamentin e fundit, 10.

Votojmë tash:

Me 75 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 10.

Tash e votojmë ligjin në tërësi.

Në sallë kemi 80 deputetë.

Konstatohet se me 75 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për shoqëritë tregtare.

Ju faleminderit!

Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për shërbimet e sigurisë private

Komisionet parlamentare, kanë shqyrtuar Projektligjin për shërbimet e sigurisë private dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Fjalën e ka kërkuar kryetari i Komisionit, deputeti Rexhep Selimi.

REXHEP SELIMI: Faleminderit, zoti kryetar!

Në emër të Komisionit, në cilësinë e kryesuesit të grupit punues të këtij ligji, ju njoftoj që janë bërë të gjitha ndryshimet e nevojshme, duke u përfshirë edhe vërejtjet e deputetëve që janë bërë në leximin e parë, duke përfshirë edhe pothuaj se të gjitha

sugjerimet, qoftë të ekspertëve, qoftë të grupeve të interesit dhe mendoj se ky ligj tashmë është i gatshëm për procedim. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputet!
Vazhdojmë votimin e amendamenteve.

Amendamenti 1

Votojmë, tash:

Me 62 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2

Votojmë tash:

Me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3

Votojmë, tash:

Me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4

Votojmë, tash:

Me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5

Votojmë, tash:

Me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6

Votojmë, tash:

Me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7

Votojmë, tash:

Me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8

Votojmë, tash:

Me 61 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9

Votojmë, tash:

Me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10

Votojmë, tash:

Me 67 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11

Votojmë, tash:

Me 69 vota “për”, asnjë “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12

Votojmë, tash:

Me 71 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13

Votojmë, tash:

Me 74 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14

Votojmë, tash:

Me 68 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15

Votojmë, tash:

Me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16

Votojmë, tash:

Me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17

Votojmë, tash:

Me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18

Votojmë, tash:

Me 70 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19

Votojmë, tash:

Me 69 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20

Votojmë, tash:

Me 66 vota “për”, 3 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21

Votojmë, tash:

Me 64 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22

Votojmë, tash:

Me 69 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23

Votojmë, tash

Me 68 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24

Votojmë, tash:

Me 70 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25

Votojmë, tash:

Me 64 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 25.

Amendamenti 26

Votojmë, tash:

Me 68 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 26

Amendamenti 27

Votojmë, tash:

Me 69 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 27.

Amendamenti 28

Votojmë, amendamentin e fundit, 28

Me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 28.

Tani votojmë ligjin në tërësi.

Prezentë janë 78 deputetë.

“Për” kanë votuar 72, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miraton Ligjin për shërbimet private të sigurisë.

Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e tetë:

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për eficiencën e energjisë

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ofiçencën e energjisë dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Votojmë amendamentet:

Amendamenti 1

Votojmë, tash:

Me 61 vota “për”, asnjë kundër, 1 abstenim, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2

Votojmë, tash:

Me 62 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3

Votojmë, tash:

Me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4

Votojmë, tash:

Me 68 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5

Votojmë, tash:

Me 69 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6

Votojmë, tash:

Me 72 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7

Votojmë, tash:

Me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8

Votojmë, tash:

Me 71 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9

Votojmë, tash:

Me 69 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10

Votojmë, tash:

Me 72 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11

Votojmë, tash:

Me 72 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12

Votojmë, tash:

Me 69 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13

Votojmë amendamentin e fundit, 13

Me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 13.

Tani votojmë ligjin në tërësi.

Votojmë, tash:

Në sallë janë 75 deputetë.

Me 74 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për ofiçiençën e energjisë.

Vazhdojmë pikën e nëntë të rendit të ditës:

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për gjendjen civile

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për gjendjen civile dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

A ka dikush të thotë diçka? Jo.

Vazhdojmë votimin.

Amendamenti 1

Votojmë, tash:

Me 69 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2

Votojmë, tash:

Me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3

Votojmë, tash:

Me 68 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4

Votojmë, tash:

Me 61 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5

Votojmë, tash:

Me 61 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 5.

Amendamenti 6

Votojmë, tash:

Me 60 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 6.

Amendamenti 7

Votojmë, tash:

Me 68 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 7.

Amendamenti 8

Votojmë, tash:

Me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 8.

Amendamenti 9

Votojmë, tash:

Me 71 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 9.

Amendamenti 10

Votojmë, tash:

Me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11

Votojmë, tash:

Me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12

Votojmë, tash:

Me 69 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13

Votojmë, tash:

Me 67 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14

Votojmë, tash:

Me 64 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 14.

Amendamenti 15

Votojmë, tash:

Me 65 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 15.

Amendamenti 16

Votojmë, tash:

Me 69 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17

Votojmë, tash:

Me 69 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18

Votojmë, tash:

Me 72 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19

Votojmë, tash:

Me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20

Votojmë, tash:

Me 70 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21

Votojmë, tash:

Me 69 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 21

Amendamenti 22

Votojmë, tash:

Me 70 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 22.

Amendamenti 23

Votojmë, tash:

Me 72 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 23.

Amendamenti 24

Votojmë, tash:

Me 68 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 24.

Amendamenti 25

Votojmë, tash:

Me 70 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 25.

Amendamenti 26

Votojmë, tash:

Me 70 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 26.

Amendamenti 27

Votojmë, tash:

Me 71 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 27.

Amendamenti 28

Votojmë, tash, amendamentin e fundit

Me 66 vota “për”, asnjë “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 28.

Në sallë kemi 76 deputetë.

Tash e votojmë ligjin në tërësi.

Konstatohet se me 77 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për gjendjen civile. Ju faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e dhjetë të rendit të ditës:

10. Shqyrtimi i Planit kombëtar të shpërndarjes së spektrit radio -fekuencor

Komisioni funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri ka shqyrtuar Propozim - planin kombëtar të shpërndarjes së spektrit radio - frekuencor dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Fjalën e ka kryetari i komisionit funksional, deputeti Zenun Pajaziti, për arsyetimin e raportit me rekomandime.

ZENUN PAJAZITI: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në mbledhjen e mbajtur më 14.6.2011, e ka shqyrtuar Planin kombëtar të shpërndarjes së spektrit radio-frekuencor dhe në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit ka organizuar po ashtu edhe dëgjim publik, ka marrë informacione shtesë edhe nga palët e interesit, ndërkaq më datën 14 e ka vlerësuar se Planin kombëtar i shpërndarjes së spektrit radio-frekuencor, i parashtruar nga Autoriteti i Rregullatorit të Telekomunikacionit, është në pajtim me nenin 63, pika a, b dhe c të Ligjit numër 2002/7 të Telekomunikacionit, të ndryshuar me Ligjin numër 3-L-o85 dhe ia rekomandon Kuvendit për miratim këtë plan. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Atëherë, radha është e grupeve parlamentare.

Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputeti Berat Buzhala e ka kërkuar fjalën.

BERAT BUZHALA: Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës i jep mbështetje këtij plani kombëtar të shpërndarjes së spektrit radio-frekuencor, mendon se i plotëson nevojat edhe kërkesat edhe mbulon gjithë territorin e Kosovës në përputhje me të gjitha planet tjera të shteteve në rajon dhe më gjerë. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të LDK-së, deputetja Teuta Sahatqija.

TEUTA SAHATQIJA: Faleminderit, kryetar!

Në Komision Parlamentar për Zhvillim Ekonomik është shqyrtuar Planin kombëtar i shpërndarjes së spektrit radio-frekuencor, si dhe është mbajtur dëgjimi publik me aktorët relevantë dhe partnerët e interesuar në këtë lëmi.

Grupi Parlamentar i LDK-së, gjithashtu e ka analizuar Planin kombëtar të shpërndarjes së spektrit frekuencor, ndikimin e tij në vendosjen e rregullit tek përdoruesit, si dhe lejimin e mundësive për teknologji të gjeneratave të reja si dhe përdoruesve të rinj. Në rend të parë, është për t'u përgëzuar hartimi i planit të tillë, për herë të parë nga ana e autoriteteve tona vendore. Brezi frekuencor është një pasuri e shtetit dhe kontrolli mbi përdorimin e këtij thesari përmes Planit kombëtar për shpërndarjen e radio-frekuencave praqet shenjë e sovranitetit të një shteti.

Ky plan, së bashku me veprimet tjera të nevojshme, hap rrugë për anëtarësim në organizata relevante për telekomunikacion si ATU. Me këtë plan vendoset harta e përdorimit të radio-frekuencave për breza dhe përdorime të ndryshme, duke u nisur nga spektri HF për përdorime në largësi, për komunikime në largësi, në brezin amator, në VHF dhe UHF, për përdorimin në shërbime publike, ushtarake, private, në brezin radio-difuziv për media, brezin mikrovalor, si dhe për shërbimet e telefonisë.

Nga ky plan shihet se ende një pjesë e brezit radio-fekuentor, kryesisht në frekuencat e ulëta të brezave kontrollohet dhe administrohet nga ana e KFOR-it për frekuenca për përdorime militare. Hartimi i planit, lëshimi i licencave, kontrollimi i përdorimit të tyre, kontrollimi i interferencave ndikon në vendosjen dhe mbajtjen e rregullit tek përdoruesit e licencuar dhe eliminimin e përdoruesve ilegalë. Gjithashtu, ky plan bën rekomandime për përzgjedhjen e pajisjeve të cilat plotësojnë kërkesat për përdorim në Evropë. Brezat e licencuara për përdorim në tregun evropian ATU kompatible. Tash për tash, sipas Ligjit ekzistues të Telekomunikacionit, ka kolizion në mes të kompetencave të KPM-së dhe ART-së në lidhje me licencat e lëshuara për kompanitë mediale, gjë të cilën Ligji i ri për Telekomunikacion duhet të eliminojë dhe të precizojë qartë këto kompetenca. Mendojmë se mënyrat e ndryshme të licencimit në afatet e ndryshme, nisur nga 6 muaj deri në 4 vjet, krijojnë ambient të përshtatshëm për biznese me nevoja të ndryshme dhe fleksibilitet gjatë renovimit të frekuencave.

Gjatë hartimit të planit dhe ndryshimeve eventuale në të duhet pasur kujdes që të mos ngulfatet mundësia e penetrimit të operatorëve të rinj, si dhe gjeneratat e reja teknologjike, sidomos në brezin 900 dhe 1800 megahercë për telefoninë mobile.

Kur flitet për Planin kombëtar të shpërndarjes së radio-frekuencave, duhet të flitet edhe për mënyrën e monitorimit të spektrit dhe identifikimit dhe eliminimit të interferencave dhe pengimin e operatoreve ilegalë. Kërkojmë që plani i shpërndarjes të mbështetet me funksionalizimin e stacionit fiks për monitorim dhe me përdorimin e stacioneve mobile. Ndonëse Planin i shpërndarjes së spektrit të radio-frekuencave parqet rregull në shfrytëzimin nga përdoruesit, mendojmë se duhet të kihet parasysh shpërndarja e drejtë, sidomos në brezin 900 megahercë, në mënyrë që të mundësohet ambient për teknologji dhe gjenerata të reja.

Grupi Parlamentar i LDK-së përkrah aprovimin e Planit kombëtar të shpërndarjes së frekuencave dhe do të kërkojmë në periudha të rregullta raportin nga ART-ja për mbarëvajtjen, shfrytëzimin dhe mënyrën e shfrytëzimit të spektrit frekuencor. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të “Vetëvendosjes”, deputeti Visar Ymeri e ka fjalën.

VISAR YMERI: Faleminderit, kryetar!

Deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Edhe Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” mbështet Planin për shpërndarjen e brezave radio-frekuencor të Kosovës. Konsiderojmë që është shumë e rëndësishme dhe është shumë mirë që Kosova tash do ta zbatojë një plan të vetin radio-frekuencor dhe në këtë drejtim shpresojmë që kjo do t’i ndihmojë pavarësimin të plotë të Kosovës në aspektin e radio-frekuencave dhe përgjithësisht në aspektin e transmetimit dhe telekomunikimit.

Planin, natyrisht, i ka disa vërejtje, shumë prej tyre u përmendën këtu. Unë, çka kisha dashur të potencoj, është vetëm që do të kisha dëshiruar dhe kërkojmë nga ART-ja, si

grup parlamentar, që vërtet ta zbatojë këtë plan në tërë territorin e Kosovës, pra që të mos kemi cungime të zbatimit të planit nëpër ato pjesë të territorit të Kosovës, të cilat tash nga të gjithë po konsiderohen si pjesë e territorit të Kosovës, në të cilat nuk ka shtrirje institucionale të Kosovës. Pra, konsiderojmë që plani duhet të jetë i zbatueshëm dhe të zbatohet me ngulm nga ART-ja, pavarësisht se për të cilat pjesë të territorit të Kosovës flasim, për shkak se kjo është e vetmja mënyrë që të themi se e kemi vërtet një plan, i cili e mbulon tërë Kosovën dhe një plan i cili i shërben Kosovës, sovranitetit të Kosovës, por edhe zhvillimit ekonomik e telekomunikues të Kosovës. Faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës e mbështet planin kombëtar të shpërndarjes së spektrit radio-frekuencor dhe mendojmë se është një plan i mirë, nuk është aspak e tepërt edhe një herë të thuhet se është tepër me rëndësi që tani ky plan të implementohet, do të thotë të zbatohet kështu si do ta votojë, sipas të gjitha gjasave, Kuvendi sot.

Po ashtu, mendoj se në anën tjetër duhet të ceket se, nëse plani i cili sot votohet, nuk do të jetë i implementueshëm, atëherë ne do ta bëjmë një gabim më të madh se sa të mos e votonim fare, do të thotë apeli është që edhe ne si Kuvend të jemi tepër të kujdesshëm që ky plan të implementohet. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Koalicionit Kosova e Re, fjalën e ka deputetja Myzejene Selmani.

MYZEJENE SELMANI: Ju faleminderit, kryetar!

Përsëritje për kryeministrin dhe zëvendëskryeministrin,

Të gjithë deputetët që janë sot prezentë në këtë seancë,

Duke marrë parasysh se në Komision Parlamentar, siç potencoi edhe kryetari, është mbajtur një mbledhje dhe një dëgjim publik për këtë Plan kombëtar të shpërndarjes së spektrit radio-frekuencor, duke marrë parasysh se deri më tani Kosova ka funksionuar në bazë të një plani të UNMIK-ut, duhet të përsëritet ART-ja për një sfidë të madhe që ka arritur në këtë aspekt, duke u bazuar në Ligjin e telekomunikacionit dhe njëkohësisht duke u bazuar në direktivat e Komisionit Evropian, të cilat e ofrojnë Kosovën shumë afër kodit të saj telefonik të telefonisë mobile dhe të telefonisë fikse.

Rëndësia e këtij dokumenti është shumë e madhe dhe duke marrë parasysh se ART-ja është organ i Kuvendit të Kosovës, të cilin e kemi zgjedhur vet, duhet të kërkojmë në mënyrë thuajse mujore të shohim se si po implementohet ky Plan kombëtar për shpërndarjen spektrit radio-frekuencor. Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij plani dhe zbatueshmërinë e këtij plani, Koalicioni për Kosovën e Re përkrah dhe uron që ART-ja ta zbatojë pikë për pikë këtë plan. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Nga Grupi SLS, nuk paska.

Nga Grupi “6+”, deputeti Albert Kinolli e ka kërkuar fjalën.

ALBERT KINOLLI: Ju faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

Zoti kryeministër,

Të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar “6+” e ka shqyrtuar këtë projekt për Planin kombëtar për shpërndarjen e spektrit radio-frekuencor dhe mendon se është mjaft i rëndësishëm, i nevojshëm dhe i mirë dhe besojmë se do të zbatohet në përpikëri dhe në e mbështesim dhe do ta votojmë si të tillë. Faleminderit!

KRYETARI: Regjia, bjeri ziles! Në sallë janë prezentë 57 deputetë, ora është 11,35, nuk besoj se kemi bërë aq punë sa të lodhemi e mos të jemi prezentë kur votohet.

Në sallë janë tani 67 deputetë. Mund të shkojmë në procedurën e votimit.

Lus deputetët dhe regjinë që të përgatiten për votim. Votojmë, tash.

Me 64 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi Planin kombëtar për shpërndarjen e spektrit të radio-frekuencave.

Vazhdojmë me pikën e radhës:

11. Shqyrtimi i Propozim- vendimit të Qeverisë së Republikë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Qeveria e Republikës së Kosovës e ka proceduar në Kuvend Propozim- vendimin për emërimin e anëtarëve të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Komisioni FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë të Kosovës ka shqyrtuar propozimin e Qeverisë dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim. A ka nevojë për fjalën e përfaqësuesit të Qeverisë? Nuk ka.

Kryetari i Komisionit FunkSIONAL, deputetit Ahmet Isufi, a e do fjalën? Ahmet Isufi e ka fjalën.

AHMET ISUFI: Ju faleminderit, kryetar!

Të nderuar deputetë,

Komisioni e ka shqyrtuar Propozim-vendimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Agjencionit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe e ka aprovuar në Komision, duke i rekomanduar Kuvendit që ta aprovojë listën me emrat e anëtarëve të Komisionit. Për mbikëqyrës kryesor shtetëror të Këshillit propozohet zoti Ruzhdi

Jashari, ndërsa për anëtarë janë zoti Ramadan Qehaja, zoti Mentor Hoxhaj, zoti Bekim Demiri dhe zoti Aleksandar Spasiq. Prandaj, konsiderojmë se janë përmbushur kushtet që të aprovohet ky propozim- vendim i Qeverisë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Fjala është tash e grupeve parlamentare.

Në emër të grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, fjalën e ka kërkuar deputeti Elmi Reçica.

ELMI REÇICA: Përshëndetje i nderuar kryetar!

I nderuar kryeministër,

Kabinet qeveritar,

Grupi Parlamentar i PDK-së e ka shqyrtuar me vëmendje propozimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, numër 03/14 të datës 04.05.2011, për emërtimin e anëtarëve të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, kështu që e mbështesim plotësisht këtë vendim dhe i ftojme të gjithë deputetët të votojnë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, deputeti Armend Zemaj e ka fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Kolegë deputetë,

Vendimi i Qeverisë numër 3, 04.14, i datës 4.5.2011, për propozimin e mbikëqyrësit kryesor shtetëror dhe mbikëqyrësit e Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas mendimit të grupit parlamentar, është në kundërshtim me vetë ligjin dhe normat elementare të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e të drejtës së privatësisë.

Ky agjencion ka mision mbrojtjen e të drejtës së privatësisë, si e drejtë themelore e qytetarëve, e garantuar me Kushtetutë. Konsiderojmë se në këtë agjencion duhet të emërohen ekspertët më të mirë dhe njerëz të cilët nuk janë direkt të përfshirë në aktivitete politike, sepse pavarësinë e mbikëqyrësit kryesor shtetëror dhe mbikëqyrësve shtetëror të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale e përcakton edhe neni 29, paragrafi 1 i Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Duke marrë parasysh praktikën e zgjedhjes së udhëheqësve të agjencive homologe në rajon dhe vende të BE-së dhe sidomos rreth zgjedhjeve të udhëheqjeve të mbrojtjes së të dhënave personale, siç emërtohen, duhet të arrihet po thuaj se një konsensus parlamentar, duke përzgjedhur njerëz të cilët kanë integritet të lartë, njohuri të thella sa i përket aspektit juridik të fushës së privatësisë dhe teknologjisë informative. Kjo është normale, duke marrë parasysh se janë njerëz të cilët do të kujdesen për mbikëqyrjen dhe përpunimin e të dhënave personale, si segmenti më i rëndësishëm i të drejtës së privatësisë.

Prandaj, Grupi Parlamentar i LDK-së kërkon nga Qeveria që ta tërheqë këtë propozim-vendim dhe ta shqyrtojë e ta sjellë me njerëz adekuat. Gjatë mandatit të kaluar, në fund të vitit është votuar kundër një propozim-vendimi të këtillë dhe ka qenë edhe emri i një personi që është prapë i përfshirë këtu, zotëri Ruzhdi Jashari, dhe i është nënshtruar

vendimit të Kuvendit “kundër”. Prandaj, kjo është edhe shkelja e dytë që nuk është dashur të përsëritet. Edhe pse ndonjëri prej kandidatëve gëzon respekt dhe mund të jetë shumë profesional, si gjenerali Qehaja, por të tjerët nuk i plotësojnë kushtet as vetëm sipas këtij ligji. Faleminderit! Domethënë, Grupi Parlamentar është kundër edhe nëse hidhet në votim.

KRYETARI: Prej “Vetëvendosjes”, kush e do fjalën? Deputeti Rexhep Selimi e ka fjalën.

REXHEP SELIMI: Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje”, duke marrë pjesë aktive edhe në komisionin përkatës – komisionin funksional përkatës, ka shqyrtuar propozimin e Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, por duke vlerësuar nevojën me gjithë vërejtjet që i kemi, duke vlerësuar nevojën e emërimit të këtyre anëtarëve, ne i përkrahim kandidatët e propozuar. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Aleancës? E thanë, u pajtuan! Në emër të Aleancës për Kosovën e Re, Muzejene Selmani.

MUZEJENE SELMANI: Faleminderit, kryetar!

Grupi Parlamentar i Koalicionit për Kosovë të Re e përkrah këtë vendim të Qeverisë dhe shpresoj se do të votohet dhe do të kalojë sot. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të SLS, deputeti Sasha Milosavljeviq.

SAŠA MILOSAVLJEVIĆ: Hvala, gospodine predsjedniče!

I Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke razmotrila je ovu odluku Vlade i podržaćemo ovu odluku, glasaćemo za.

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit “6+” a e do dikush fjalën? Duda Balje e ka fjalën.

DUDA BALJE: Zahvaljujem! Parlamentarna grupa “6+” podržava Predlog odluke Vlade Republike Kosova i glasaće za njega.

KRYETARI: Faleminderit! Të lajmëruar më nuk ka. Atëherë, shkojmë në votim.

Në sallë kemi prezentë 79 deputetë. Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim dhe votojmë tash:

Konstatoj se me 58 vota “për”, 19 “kundër”, 2 abstenime, Kuvendi miratoi anëtarët e Agjencisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, me mandat pesëvjeçar, si vijon:

- Ruzhdi Jashari, mbikëqyrës kryesor shtetëror i Agjencisë,
- Ramadan Qehaja, mbikëqyrës shtetëror,
- Mentor Hoxhaj, mbikëqyrës shtetëror,
- Bekim Demiri, mbikëqyrës shtetëror, dhe

- Aleksandar Spasiq, mbikëqyrës shtetëror.

Prezentë ishin 81 deputetë! Faleminderit!

Vazhdojmë me pikën e fundit të rendit të ditës:

12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për sigurimin e detyrueshëm nga auto-përgjegjësia ndaj palëve të treta.

Komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për sigurimin e detyrueshëm nga auto-përgjegjësia ndaj palës së tretë dhe Kuvendit i kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Para se të procedojmë me votimin e amendamenteve, ftoj kryetaren e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, deputeten Safete Hadërgjonaj, që para deputetëve ta arsyetojë raportin me rekomandime. Fjalën e ka deputetja Safete Hadërgjonaj.

SAFETE HADËRGJONAJ: Faleminderit, zoti kryetar!

Komisioni për Buxhet dhe Financa, në pajtim me nenin 57 dhe 68 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më datën 22.6.2011 shqyrtoi Raportin numër 04/L-018 për sigurimin e detyrueshëm nga auto-përgjegjësia ndaj palëve të treta, të propozuar nga Qeveria dhe Kuvendit i paraqet këtë raport.

Komisioni për Buxhet ka konstatuar se ky projektligj nuk ka implikime buxhetore dhe i ka rekomanduar Kuvendit që ta bëjë miratimin e amendamenteve.

Komisioni për Buxhet ka punuar edhe në disa takime tjera të cilat kanë qenë takime të Grupit punues dhe e ka shqyrtuar me kujdes shumë të madh, prandaj i ftoj të gjithë deputetët që t'i votojnë këto amendamente të këtij projektligji.

KRYETARI: Kalojmë në procedurën e votimit.

Amendamenti 1

Me 55 vota “për”, asnjë “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 1.

Amendamenti 2

Me 60 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 2.

Amendamenti 3

Prezentë janë 74 deputetë!

Me 63 vota “për”, asnjë “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 3.

Amendamenti 4.

Me 61 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 4.

Amendamenti 5

Me 61 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 5.

Votojmë amendamentin 6

Me 59 vota “për”, 2 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 6.

Në radhë është amendamenti 7, i deputetes Suzan Novobërdaliu, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

(Ndërhyrje)

Mirë, unë nuk arrita, faji është i imi, përsëritet amendamenti 7, se s’e dhashë sqarimin..

Amendamenti 7 është i deputetes Suzan Novobërdaliu, pa përkrahjen e Komisionit funksional.

Votojmë tash:

Me 25 vota “për”, 40 “kundër”, 3 abstenime, nuk miratohet amendamenti 7.

Votojmë amendamentin 8

Me 67 vota “për”, 1 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 8.

Në radhë është amendamenti 9 – Komisioni funksional dhe deputetja Suzan Novobërdaliu.

Do të thotë, kjo është në pajtim, a? Mirë!

Votojmë tash:

Me 55 vota “për”, 5 “kundër”, 3 abstenime, Kuvendi miratoi amendamentin 9.

Në radhë është amendamenti 10.

Votojmë tash:

Me 64 vota “për”, 2 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 10.

Amendamenti 11

Me 63 vota “për”, 1 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 11.

Amendamenti 12

Me 62 vota “për”, 3 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 12.

Amendamenti 13

Me 63 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 13.

Amendamenti 14 – Deputetja Suzan Novobërdaliu me përkrahjen e komisionit funksional.

Votojmë tash:

Me 59 vota “për”, 10 “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 14.

Për amendamentin 15 kemi dy propozime:

Votojmë amendamentin a) të Komisionit funksional:

Me 67 vota “për”, 2 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 15 a)

Për variantin 15 b) s’kemi pse të votojmë.

Tani votojmë amendamentin 16 të komisionit funksional, deputetja Suzan Novobërdaliu.

Për amendamentin 16 është fjala dhe votojmë tash:

Me 60 vota “për”, 9 “kundër”, 4 abstenime, miratohet amendamenti 16.

Amendamenti 17

Me 64 vota “për”, 1 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 17.

Amendamenti 18

Me 63 vota “për”, 2 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 18.

Amendamenti 19

Me 64 vota “për”, 2 “kundër”, 2 abstenime, miratohet amendamenti 19.

Amendamenti 20 – deputetja Suzan Novobërdaliu, me përkrahjen e komisionit funksional.

Votojmë tash:

Me 67 vota “për”, 4 “kundër”, 1 abstenim, miratohet amendamenti 20.

Amendamenti 21

Me 69 vota “për”, 2 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 21.

Amendamenti 22 – është i deputetes Suzan Novobërdaliu, me përkrahjen e komisionit funksional.

(Ndërhyrje)

Komisioni e ka adresuar dhe me përkrahjen e tij është. Votojmë tash:

Me 55 vota “për”, 12 “kundër”, 3 abstenime, miratohet amendamenti 22.

Tani votojmë amendamentin e fundit 23, votojmë tash:

Me 69 vota “për”, 3 “kundër”, asnjë abstenim, miratohet amendamenti 23.

Tani votojmë Ligjin në tërësi, votojmë tash:

Në sallë kemi 73 deputetë.

Me 70 vota “për”, 5 “kundër”, 1 abstenim, Kuvendi miratoi Ligjin për sigurimin e detyrueshëm nga auto-përgjegjësia.

Dhe, tani kemi pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për nismën legislative

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit, komisioni funksional ka shqyrtuar Projektligjin dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime, për shqyrtim në parim.

Ftoj zëvendëskryeministrin Bujar Bukoshi, që në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantojë dhe arsyetojë Projektligjin.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI BUJAR BUKOSHI: Faleminderit, i nderuar zoti kryetar! Të nderuar deputetë,

Në këtë seancë më lejoni që para jush të paraqes Projektligjin për nisma legislative.

Ky projektligj është miratuar nga Qeveria me datën 25 maj të këtij viti dhe nevoja për nxjerrjen e këtij ligji rrjedh nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Duke qenë se nisma legislative deri tash nuk është rregulluar me ndonjë ligj adekuat, por nga ana tjetër kjo e drejtë garantohet me Kushtetutë, ka lindur pra nevoja për rregullimin e kësaj fushe me një legjislacion përkatës me qëllim që të mundësohet pjesëmarrja direkte, e drejtpërdrejtë e qytetarëve në procesin legjislativ.

Në këtë projektligj përcaktohen parimet e përgjithshme të cilat duhet të përmbushen me qëllim që nisma legislative të konsiderohet e rregullt, si dhe në mënyrë eksplicite të përcaktohet e drejta për të marrë nismë legislative nga autoritetet përkatëse, duke i dhënë rol të rëndësishëm pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë pra të qytetarëve në procesin legjislativ.

Ky ligj përcakton rregullat dhe procedurat për nisma legislative nga autoritetet relevante, duke përfshirë Presidentin e Republikës së Kosovës, deputetët e Kuvendit, Qeverinë dhe më së paku 10 mijë qytetarë me të drejtë vote, të cilët mund të marrin iniciativë për të rregulluar një fushë të caktuar me ligj apo ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve në fuqi.

Me këtë projektligj, pra, përcaktohet që çdo nismë legislative do të ketë organizatorin, i cili është pika e kontaktit dhe komunikimit me institucionet përkatëse. Po ashtu, njësia përkatëse që merret me çështje ligjore të Zyrës së kryeministrit, sipas nevojës dhe në bashkëpunim me institucionet dhe me shoqërinë civile ndërmarrin masat e nevojshme për të promovuar dhe përkrahur të drejtat e përcaktuara në këtë ligj.

Autoriteti mbikëqyrës për monitorimin e zbatimit të këtij ligji është Zyra e kryeministrit.

Ky projektligj është përgatitur nga Zyra e kryeministrit dhe është në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me standardet e Bashkimit Evropian. Para hartimit dhe gjatë hartimit të këtij projektligji janë bërë hulumtime dhe konsultime paraprake nga natyra e kësaj fushe.

Kjo do të ishte në pika të shkurtra sa i përket përmbajtjes së këtij projektligji dhe ju propozoj që të njëjtin ta miratoni, në mënyrë që çështjet të cilat rregullohen me këtë projektligj të vihen në suaza të kornizës ligjore adekuate. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zëvendëskryeministër! Kryetari i komisionit s'është këtu. Në emër të Grupit të Partisë Demokratike, fjalën e ka deputeti Behar Selimi.

BEHAR SELIMI: Faleminderit, i nderuar kryetar!

I nderuar zëvendëskryeministër,

Deputetë të nderuar,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike e ka shqyrtuar ligjin dhe njëkohësisht është dakord që të aprovohet, në parim.

Grupi Parlamentar e konsideron Projektligjin për nismën legislative si hap të rëndësishëm me të cilin forcohet baza juridike e institucioneve juridike dhe politike të demokracisë së drejtpërdrejtë dhe njëkohësisht konsideron se ky është hap i mirë, hap i parë, megjithatë, për promovimin në të ardhmen edhe të instituteve tjera juridike me të cilat krijohet një baraspeshë në mes demokracisë së drejtpërdrejtë dhe asaj përfaqësuese.

E konsiderojmë këtë projektligj si instrument juridik me të cilin qytetarit i mundësohet bërja e politikës dhe së këndejmi rekomandojmë që të aprovohet si i tillë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Lidhjes Demokratike, deputeti Armend Zemaj e ka kërkuar fjalën.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit shumë, kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar këtë projektligj që ka të bëjë për nismat legislative, i cili kuptohet derivon nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Sa i përket rregullimit të kësaj fushe, është më se e qartë dhe e domosdoshme duke marrë parasysh zhvillimin e demokracisë edhe në vendin tonë, po edhe të demokracisë parlamentare, ne mendojmë se gjatë hartimit dhe procedimit në komisionin funksional duhet t'i kushtohet rëndësi e veçantë të nismat legislative dhe të procedurat për të marrë nismë.

Gjatë hartimit të këtij ligji shihet, sidomos te Qeveria, e cila e ka paraqitur këtu një ngurrim të dhënia e hapësirës për nismën legislative, sidomos te procedurat që merren nga qytetarët, domethënë janë procedura burokratike, sepse në vendet e zhvilluara një nismë e cila vjen nga qytetarët, ndoshta edhe kemi parë edhe raste konkrete, organizohen edhe ceremoni në kuvende, sepse është diçka shumë domethënëse për vendin dhe vetë demokracinë.

E dyta, nisma legislative nga deputetët e Kuvendit, te neni 8, ne kemi vërejtje, sepse deputeti është përfaqësuesi i popullit dhe nuk do të thotë se duhet ta ketë domosdoshmërisht përkrahjen e gjashtë deputetëve për të marrë nismën për një projektligj të caktuar. Një vërejtje kryesore është që një deputet mund të marrë nismën për ndonjë projektligj, si nismë legislative. Andaj, këto janë vërejtjet tona parimore, të cilat do t'i

amendamentojmë dhe do t'i vëmë në funksion në punën e Komisionit për legjislacion. Faleminderit, shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të “Vetëvendosjes”? Albulena Haxhiu!

ALBULENA HAXHIU: Faleminderit kryetar!

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” ka analizuar dhe shqyrtuar me një vëmendje të veçantë Projektligjin për nisma legjislative, pasi që qytetarëve të Kosovës e drejta elementare për nisma legjislative, e garantuar me nenin 79 të Kushtetutës, për shkak të neglizhencës së treguar nga ana e Qeverisë dhe legjislaturave të kaluara tash e sa vite iu është mohuar.

Gjatë analizimit dhe shqyrtimit të këtij projektligji kemi vërejtur disa të meta, të cilat shkurtimisht do t'i paraqes me radhë.

Së pari, në paragrafin 3 të nenit 4 të këtij projektligji parashihet që: “të gjitha nismat legjislative duhet t'i përmbahen standardeve për hartimin e legjislacionit, të përcaktuara nga Qeveria, nëse nuk parashihet ndryshe me këtë ligj”. Mirëpo, në realitet këtu kemi të bëjmë me parimet themelore për hartimin e legjislacionit e jo standarde për hartimin e legjislacionit. Sido që të jetë, kur bëjmë një analizë në mes paragrafit 3 të nenit 4, nenit 7 dhe nenit 8 të këtij projektligji, atëherë mund të lind një pyetje se si mund t'i detyrojë deputetët apo edhe Presidentin që gjatë hartimit të një nisme legjislative ata të mbështeten në një akt juridik qeveritar. Rekomandoj që kjo çështje të adresohet gjatë shqyrtimit të Projektligjit në komision.

Së dyti, çështjet e rregulluara me nenin 5 dhe nenin 6 të këtij projektligji, nuk kanë karakter të dispozitave të përgjithshme, mirëpo të dispozitave materiale dhe të cilat rregullojnë pjesën më të rëndësishme të këtij projektligji.

Së treti, nismat legjislative kanë një rëndësi të veçantë, prandaj rekomandoj që të shtjellohet shumë më në detaje çështja e refuzimit të një nisme legjislative.

Pra, neni 6 duhet të jetë më i detajuar në lidhje me refuzimin e nismës, për shembull, kush do të vlerësojë në kuadër të Kuvendit të Kosovës kur një nismë legjislative është në kundërshtim me parimet themelore të Kushtetutës apo nuk i përmban kushtet e përcaktuara me këtë projektligj, Kryesia e Kuvendit, Kryetari i Kuvendit apo siç bën të nënkuptosh nga përmbajtja e nenit 19, Zyra për Propozime dhe Parashtresa.

Së katërti, neni 7, neni 8 dhe neni 9 i këtij projektligji nuk rregullojnë dhe nuk qartësojnë asgjë në aspektin e hartimit, shqyrtimit dhe procedimit të një nisme legjislative. Mirëpo, në realitet këto nene vetëm sa shkaktojnë huti dhe konfuzitet.

Në këtë moment lind një pyetje për propozuesin e këtij projektligji, se çka është rregulluar apo qartësuar më shumë me nenin, 7, 8 dhe 9 të këtij projektligji, se sa që është rregulluar me nenin 79 dhe nenin 54 të Rregullores së Kuvendit.

Së pesti, në paragrafin 2 të nenit 11 të Projektligjit, pra tek pjesa e dispozitave që parashohin mënyrat e procedimit të nisma legjislativë nga ana e qytetarëve, është paraparë që organizatori i nismës është pika e kontaktit dhe komunikimit me institucionet përkatëse.

Rekomandoj që të parashihet shprehimisht organizatori i nismës është pika e kontaktit dhe e komunikimit me Kuvendin e Kosovës, e jo të thuhet – institucionet përkatëse, sepse në këtë rast kemi vetëm Kuvendin e Kosovës.

Së gjashti, kur analizojmë nenin 12 të këtij projektligji, shohim që qytetarëve iu lejohej dy mundësi: mundësia e parë është që ata vetë të hartojnë dhe propozojnë një projektligj për shqyrtim dhe miratim në Kuvend dhe, mundësia e dytë, që ata të ndërmarrin një nismë legjislativë duke i propozuar Kuvendit që ta hartojë, shqyrtojë dhe miratojë një projektligj.

Rekomandoj që tek mundësia e dytë duhet të parashihet një afat kohor, brenda të cilit Kuvendi duhet të hartojë, shqyrtojë dhe miratojë një projektligj.

Së shtati, kur analizojmë përmbajtjen e nenit 13 dhe të nenit 17 të Projektligjit, vërejmë se hartuesit e kanë përdorur termin “Njësia përkatëse për parashtresa dhe ankesa në Kuvendin e Kosovës”, e cila me rregulloren e punës së Kuvendit njihet si Zyra për Propozime dhe Parashtresa e Kuvendit. Pra, kjo çështje duhet të jetë në harmoni të plotë me Rregulloren e Kuvendit.

Së teti, sipas përmbajtjes së nenit 19 të Projektligjit, Zyra për Propozime dhe Parashtresa në kuadër të Kuvendit do të jetë kompetente edhe për analizimin e çështjeve të parapara me paragrafin 1 të nenit 6 të këtij projektligji.

Rekomandoj që në projektligj të përcaktohen qartë kushtet formale, kur kjo zyre mund të refuzojë protokollimin e një nisme legjislativë.

Së nënti, rekomandoj që në nenin 21 të Projektligjit të përfshihet një afat kohor, brenda të cilit Qeveria obligohet të përgatitë projektligjin.

Së dhjeti, me paragrafin 1 të nenit 22 parashihet nxjerrja e akteve nënligjore, mirëpo është shumë e çuditshme se sikurse me këtë projektligj, po ashtu edhe me një numër të projektligjeve të proceduara deri më tani në Kuvend, parashihet çdo herë një nen i tillë për nxjerrjen e akteve nënligjore. Mirëpo, kur ta analizosh përmbajtjen e Projektligjit, nuk sheh ndonjë dispozitë që ka paraparë rregullimin e një çështjeje të caktuar me një akt nënligjor. Pra, propozuesi i projektligjit është dashur që të parasheh saktësisht se çka duhet të rregullohet me udhëzues dhe aktet tjera përkatëse.

Së fundi, mirëpo jo edhe nga rëndësia, çështje mjaft shqetësuese dhe që nuk është rregulluar me dispozitat e këtij projektligji, si dhe dispozitat e tjera të legjislacionit në fuqi, është çështja e përgatitjes së vlerësimit të ndikimit financiar dhe deklaratës së harmonizimit me legjislacionin e BE-së për rastet kur një projektligj propozohet nga ana

e Presidentit apo deputetët e Kuvendit. Lind pyetja, kush është përgjegjës për përgatitjen e vlerësimit të ndikimit financiar dhe të deklaratës së harmonizimit me legjislacionin e BE-së për një projektligj të propozuar nga Presidenti apo deputetët e Kuvendit. Kjo çështje nuk është e rregulluar as me dispozitat e Rregullores së Kuvendit.

Po ashtu, çështja e përgatitjes së vlerësimit të ndikimit financiar dhe deklaratës së harmonizimit me legjislacionin e BE-së, për rastet kur një projektligj propozohet nga ana e më së paku 10.000 qytetarëve, nuk është rregulluar në mënyrë të qartë as me nenin 21 të këtij projektligji.

Rekomandoj që kjo çështje të adresohet gjatë shqyrtimit të Projektligjit në komision. Faleminderit!

KRYETARI: Në emër të AAK-së, deputeti Ardian Gjini e ka fjalën.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti kryetar!

Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës do ta mbështet, në parim, Ligjin për nismat legjislative. Sidoqoftë, mendojmë se pjesa më e madhe e këtij ligji provon t'i rregullojë procedurat kur një nismë legjislative vjen nga qytetarët.

Ne i kemi disa vërejtje. Në parim, besoj se duhet të diskutohet për atë se Qeveria e Kosovës propozon që një nismë legjislative mund ta marrin 6 deputetë ose më shumë, e tha kolegu Armend Zemaj më herët, e kemi diskutuar edhe në komision, mirëpo në kontekste tjera. Mendojmë se është bazë e keqe e nisjes, nëse një deputet nuk mjafton për ta nisur një nismë legjislative, po duhen disa. Do të thotë, kjo është çështje shumë parimore. Nuk guxojmë ne si Kuvend të lejojmë që një deputet mos të jetë i mjaftueshëm si legjislator. Domethënë, është gabim parimor ky.

Çështje tjetër është se në ligj parashihet që të vijnë disa elemente, sikur të ndahen fushat. Për shembull, thuhet diku, Presidenti propozon legjislacion nga fusha e tij ose e saj. Ne mendojmë se nuk ka fushë, e cila nuk bie në kompetencën e Presidentit ose Presidentes, në rastin tonë. Do të thotë, janë disa elemente të cilat tregojnë se ky ligj ndoshta është rast klasik i asaj se si Qeveria provon të marrë më shumë kompetenca ose ta komplikojë në favor të ekzekutivit procesin e ligjbërjes os të paktën të nismës legjislative. Ne e dimë se nuk është rast i vetëm Kosova. Kësi raste ndodhin gjithkund. Mirëpo, tani është koha që Kuvendi i Kosovës të tregojë se një deputet është i mjaftueshëm, nuk është i vogël deputeti, nuk është pak që një deputet të ketë mundur që ta marrë një nismë legjislative, cilado qoftë ajo, qoftë për ndryshim të ligjit ose për ligj të ri. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit për Kosovë të Re, deputeti Jeton Svirca!

JETON SVIRCA: Faleminderit, kryetar!

I nderuar kryetar,

I nderuar Kabinet qeveritar,

Të nderuar deputetë,

Koalicioni për Kosovë të Re ka shqyrtuar Projektligjin për nisma legjislative dhe në parim e mbështesim projektligjin. Për të mos i përsëritur disa nga vërejtjet të cilat i dhanë kolegët tanë, ne kontributin tonë do ta japim në komisionin përkatës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të SLS-së, a e do dikush fjalën? Deputetja Jelena Bontiq e ka fjalën.

JELENA BONTIĆ: Hvala, gospodine predsjedavajući!

Pročitali smo Nacrt zakona o zakonodavnim inicijativama zajedno sa pratećim dokumentima koji se tiču usklađenosti sa zakonodavstvom Evropske unije. Smatramo da je ovaj zakon potreban jer reguliše važnu materiju i najvažnije u ovoj materiji je da se građanima omogućava inicijativa da učestvuju u zakonodavnoj aktivnosti, direktno utiču na rešavanje društvenih problema. Uglavnom se radi o Nacrtu koji obuhvata suštinu, relativno je sreden, mada bih da dodam da ćemo mi kasnije, na drugom čitanju i kroz komisije da utičemo da se ovaj zakon sredi i otklone jezičke nelogičnosti kod pojedinih odredbi.

Što se tiče svrhe ovog zakona, vidi se da se radi o jednoj sasvim razumnoj i praktičnoj svrsi. Predviđeno je jasno ko ima pravo da pokrene zakonodavnu inicijativu i ja bih ovde da dodam da je ovaj zakon potreban kosovskom društvu. Svakako da mi prihvatamo ovaj nacrt jer odražava suštinu sa napomenom da se u ovaj nacrt do drugog čitanja isprave nelogičnosti i nejasne formulacije, te će Parlamentarna grupa Samostalne liberalne stranke u tom pogledu dati svoj doprinos i glasati za ovaj nacrt zakona. Hvala vam!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit “6+”, deputetja Myfera Shinik, e ka fjalën!

MÜFERA ŞINIK:

Teşekkür ederim Sayın Meclis Başkanı

Bilindiği üzere Yasama girişimleri ile ilgili Yasa Tasarısı, herhangi bir alanda Yasanın tekrar görüşülmesini, değişiklik ve tamamlamaların yapılmasını amaç edinmektedir. Bu değişiklikler, yürürlükte olan yasalar ve Kosova Cumhuriyeti Anayasasına göre yapılmalıdır.

Bu Yasa Tasarısının titizlikle hazırlandığını görüyoruz. Ancak birçok yasalarda olduğu gibi, üç dildeki tercümede farklılıklar görülmektedir. Tercümeye dikkat edilmesi gerekir. Yasa Tasarısının 15. maddesine göre, yasama girişimleri için, daha doğrusu yasadaki değişikliklerin yapılması için imza toplamakta harcamaların organizatöre ait olması ve Kosova Cumhuriyeti Meclisine maddi kaynakların bildirilmesi gereği vurgulanmaktadır.

Değişiklikler yapılması gereken yasanın toplum çıkarına önem taşıdığı takdirde, organizatör maddi kaynak bulamadığı halde, harcamaların Kosova kurumları tarafından desteklenmesi gerektiğine inanmaktayız.

Ek önerileri komisyonlara vererek ve ikinci okunuşuna katkı sunacağımızı belirterek, 6+ Parlamento Grupu olarak Yasama girişimleri ile ilgili Yasa Tasarısının birinci okunuşunu kabul etmekteyiz.

Teşekkür ederim.

KRYETARI: Faleminderit! Deputeti Sabri Hamiti, e ka fjalën!

SABRI HAMITI: Zoti kryetar i Kuvendit,

Zotni zëvendëskryeministër,

Deputetë të çmuar e të nderuar,

Ne kemi një projektligj për nismat legislative, i cili provon që të kodifikojë nismat legislative të cilat në empiri kanë ekzistuar dhe unë ju bëj thirrje deputetëve të ri mos të mendojnë që ka filluar dynjaja në këta tre muajt e fundit, po kur të bëjnë rekapitullime, le të lexojnë, ka dokumente në Kuvend, edhe legislative, nisma e ndodhi, e të gjitha dhe unë po ndalem këtu.

Po ju them që ka këtu deputetë që janë edhe brenda, që kanë bë jo nisma, po që kanë hartuar ligje, që i ka miratuar Kuvendi dhe janë në zbatim. Domethënë, nuk është këtu diçka që po fillon sot, sepse normalisht edhe s'mund të ishte kështu.

Po kthehem te projekti. Pra, ka një tendencë që të kodifikohet sa më qartë ky projekt për nisma legislative dhe u tha këtu, pjesa më e madhe e thjeshtë, kodifikimi i kësaj nisme kur bëhet nga qytetarët dhe është mirë që kjo pjesë edhe të jetë shumë më e saktësuar, sepse këto të tjerat janë provuar të gjitha, të gjitha, edhe si ligje të propozuara prej Qeverisë, që janë dominonte, edhe nga Presidenti, edhe nga deputetët dhe nga një deputet, dhe këtu duhet t'ju kujtoj dy kolegëve, Gjinit dhe, më duket, Zemajt, që janë të dy deputetë edhe të legjislacionit tjetër. Një deputet ka propozuar këtu iniciativa gati për javë, e ai është deputeti më i vyeshëm, Smakaj, që s'e kemi këtu. Dhe, si iniciativë, deputeti e ka pasur të drejtën edhe përpara që të japë iniciativë, po duhet ta diferenconi problemin – ç'është iniciativë, ç'është hartim i ligjit, grupi i hartimit, se është lehtë një deputet dhe bile me nenin 79 të Kushtetutës, ku po mbështetet ky ligj, lejohet. Thotë deputetët, në shumës, por kjo i bie që secili ka të drejtë, domethënë sipas ligjit, kështu që është e rregulluar, nuk ka nevojë kjo të thuhet – jo duhen gjashtë vetë. Secili deputet, sipas Kushtetutës, neni 79, ka të drejtë të japi iniciativa. Po është punë tjetër hartimi, grupi i hartimit. Është punë tjetër që çdo ligj që pretendon të rregullojë një fushë në Kosovë, duhet të bëhemi real, s'ka shans të funksionojë, të aplikohet pa një kosto financiare, të cilën për kah natyra e jep Qeveria, prandaj konsultohet gjithmonë Qeveria ta bëjë koston e realizimit të një ligji dhe këtu duhet të jetë edhe kjo. Nuk është puna që s'ka të drejtë Kuvendi të hartojë ligje, se ka hartuar. Nuk është puna grupet që s'kanë të drejtë, deputetët, qytetarët, por në finale çdo ligj që rregullon një jetë, një pjesë të jetës të qytetarëve të Kosovës, për t'u bërë funksional duhet të ketë mbulesë financiare, që i bie më shkurt e më shqip – para, të realizohet dhe kjo, për kah natyra, e jep konsultimin me ekzekutivin. Jo pse ata duhet ta kontrollojnë mënyrën e ndërtimit të ligjit, po edhe ekzekutivit, nëse nisma i thotë - ne po ju japim ide që është mirë të bëhet ky ligj, po ne

s'e hartojmë, atëherë duhet të ndërtohet edhe në kohë, edhe në hapësirë relacioni në mes të atij që harton dhe atij që bën nismë.

Dhe, unë, nuk dua ta zgjas më tutje, por po them – ka mundësi, ka pika, e sidomos pika të pa adresuara saktë, mua më duket neni 6, besoj që është gjashtëshi, ku thotë: referencë në Rregulloren e Kuvendit. Shikoni! Cilën rregullore? Nuk mund të bëhet ligji me kohë të pa caktuar, në mbështetje të një rregulloreje të Kuvendit, që është shumë virtuale, se me dy të tretat ky Kuvend mundet pasnesër ta ndërrojë rregulloren e vet dhe e bie ligjin në pikëpyetje, si arsyetim.

Prandaj, duhet që formulimet të jenë të sakta. Në Rregulloren e Kuvendit, që saktëson raportin me këtë legjislacion, i cili është i kushtëzuar nga neni 79 i Kushtetutës, e tjera. Unë nuk dua të bëj formulime të sakta tash, po jo blanko në Rregullore të Kuvendit, se Rregulloren e Kuvendit fundi i fundit çdo legjislaturë e ka të detyrueshme ta rishoh ose ta bëjë të veten. Ndërsa, ligji nuk është ligj që duhet të kufizohet me legjislaturë, qoftë e prerë para kohe, qoftë e çuar deri në ditët e fundit. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Replikë, Armend Zemaj!

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, kryetar!

Faktikisht, unë iu referova nenit 8, ashtu siç është propozuar nga Qeveria e Republikës së Kosovës, mënyra e nismës legjislative, që thotë – së paku gjashtë deputetë të Kuvendit kanë të drejtë të nismës për të propozuar ligje, sipas mënyrës së përcaktuar me Rregulloren e Punës së Kuvendit. Dhe unë i kuptoj nismat legjislative që kanë qenë në mandatin e kaluar nga deputetët individual, të cilat nuk kanë qenë të formalizuara dhe unë po flas për nisma legjislative të cilat janë të kompletuara dhe vijnë e parashtrohen në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Kjo ishte.

KRYETARI: Ligji kur bie ndesh me Kushtetutën, Kushtetuta është ajo që...kështu që ju mos lejon që ligji të bëhet në shpërputhje me Kushtetutën. Diskutuesi i fundit për këtë ligj është deputeti Halit Krasniqi.

HALIT KRASNIQI: Unë nuk do të ndalem te empiria e këtij Kuvendi dhe as te praktikat që janë ndjekur në të kaluarën, por do të ndalem, do të fokusohem në Projektligjin që e ka sjellë Qeveria këtu. Nevoja për nxjerrjen e këtij ligji buron nga Kushtetuta e Republikës së Kosovës. Meqenëse kjo e drejtë qytetare e ka bazën kushtetuese dhe deri tani nuk është rregulluar me ndonjë ligj adekuat, është kërkesë e kohës për rregullimin e kësaj fushe me legjislacion përkatës, me idenë që të kenë mundësi për të kontribuar qytetarët drejtpërdrejt në procesin legjislativ.

Ky ligj përkufizon rregullat dhe procedurat për nismat legjislative nga autoritetet me relevantë, duke filluar nga Presidenti i Republikës së Kosovës, deputetët e Kuvendit, Qeveria dhe 10.000 qytetarë me të drejtë vote.

Projektligji që është sjellë nga Qeveria, ka adresuar çështje me kompetencë, por që konsideron se duhet të plotësohen.

Me këtë projektligj përcaktohen rregullat dhe procedurat e domosdoshme për nismën legjislative nga institucionet e Republikës së Kosovës, si dhe nga qytetarët, si e drejtë kushtetuese e tyre. Deri këtu është një kontribut i çmueshëm dhe me disa propozime plotësuese ky projektligj merr fizionomi të plotë.

Në Projektligjin për nismë legjislative përmbledhen në mënyrë të përcaktuar parimet e përgjithshme, të cilat kërkohet doemos të përmbushen me qëllim që nisma legjislative të konsiderohet e rregullt, si dhe në mënyrë eksplicite përcaktohet e drejta për të marrë nismë legjislative nga autoritetet përkatëse, duke i dhënë rolin meritë pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë të qytetarëve në procesin legjislativ.

Së paku 10.000 qytetarë me të drejtë vote mund të marrin iniciativë për të rregulluar një fushë të interesimit të tyre me ligj, apo për të ndryshuar dhe plotësuar një ligj të plotfuqishëm.

Në këtë amendament duhet të bëhet një përmirësim. Në shikim të parë, të krijohet përshtypja e aspektit redaktues, por që me këtë ndryshim fiton cilësim logjik dhe profesional.

Me këtë projektligj gjithashtu është paraparë mënyra e fillimit të nismës legjislative, financimi i nismës legjislative, përmbajtja e listës së nënshkrimeve, verifikimi i listës, e drejta e ankesës për rastet kur bëhet refuzimi i nismës legjislative. Janë përshkruar fazat e shqyrtimit të projektligjit, si dhe nxjerrja e udhëzuesve dhe akteve tjera përkatëse të domosdoshme për t'u bërë i zbatueshëm ligji.

Strukturimi i Projektligjit të nismës legjislative është bërë dhe është përkufizuar në gjashtë kapituj dhe gjithsej 23 nene.

Në kapitullin e parë, janë dispozitat e përgjithshme, duke përfshirë qëllimin, fushëveprimin, përkufizimet, parimet e përgjithshme për nismën legjislative dhe për drejtën e nismës legjislative.

Kapitulli i dytë, përkufizon nismën legjislative nga institucionet e Republikës së Kosovës. Në pikën 1.2 duhet të ndryshohet “nga deputetët e Kuvendit” – “deputeti i Kuvendit”, sepse pastaj mbyllen komentet, 1, 2 a 6.

Kapitulli i tretë, përfshin nismën legjislative nga qytetarët me të drejtë vote, si dhe ndalimin e çfarëdo forme të aspekteve diskriminuese për të marrë nismë legjislative, si dhe shqyrtimin e projektligjit apo propozim- projektligjit. Ky amendament duhet të ndryshojë konstruktin e fjalisë “organizatori i nismës”, në “propozues të nismës legjislative”.

Kapitulli i katërt dhe i pestë, parasheh procedurat dhe kriteret për nismën legjislative, si dhe shqyrtimin e projektligjit apo propozim-projektligjit.

Në pikën 1 të nenit 15, “bartja e shpenzimeve”, nuk është konceptuar drejtë dhe duhet të ndryshohet. Fillimisht, duhet t’i mbulojë shpenzimet iniciuesi i nismës legislative, por kur propozimi i nismës qytetare të kalojë në Kuvend, duhet të parashihet kompensimi. Dhe kjo nuk është bërë.

Kjo të rregullohet edhe në pikën 2 të njëjtit nen, duke shtuar fjalinë: “deklarimi i shpenzimeve të bëhet edhe për arsye të kompensimit të shpenzimeve për koston nga fillimi i nismës e deri te ardhja e saj në Kuvend”. Kështu i motivojmë qytetarët për të ndërmarrë iniciativa të interesit qytetarë, pa qenë të hendikepuar nga shpenzimet.

Kapitulli i katërt, përcakton dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

Si përfundim, kam konstatuar se projektligji është interes i qytetarëve të Republikës së Kosovës, e begaton demokracinë, është në përputhje me Kushtetutën dhe, si i tillë, në parim duhet të përkrahet.

KRYETARI: Faleminderit! Nuk kemi më të lajmëruar për diskutim. Shkojmë në procedurën e votimit.

Në sallë janë prezentë 72 deputetë dhe tani kërkohet miratimi në parim i Projektligjit për nismat legislative.

Lus deputetët dhe regjinë të përgatiten për votim, votojmë tash:

Me 70 vota “për”, asnjë “kundër”, asnjë abstenim, Kuvendi miratoi në parim Projektligjin për nismat legislative.

Kërkohet nga komisioni funksional dhe komisionet e përhershme që në afatin e paraparë me Rregulloren të Kuvendit ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit t’i paraqesin raportin me rekomandime.

Mirupafshim, në seancën e radhës!

Përgatiti:

Njësia për Transkripte dhe Lekturë e Kuvendit të Kosovës